



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

LEGJISLATURA IV

Sesioni pranveror

Komisioni për Bujqësi, Pylltari, zhvillim Rural, Mjedis dhe Planifikim Hapësinor

Mbledhja nr. 42

Prishtinë, më 10.1.2012, ora 11,00

Ndërtesa e Kuvendit, salla C-203

PROCESVERBAL
I MBLEDHJES SË KOMISIONIT

Në mbledhje morën pjesë: Nait Hasani, Liburn Aliu, Rasim Demiri, Nijazi Idrizi, Salih Morina, Sevdije Lama, Afërdita Berisha-Shaqiri, Etem Arifi, Daut Haradinaj.

Të ftuar dhe pjesëmarrës tjerë: bashkëpunëtor nga GP, përfaqësues dhe vëzhgues të interesuar (KDI, OSBE), përfaqësuesi nga Ambasada Amerikane, zyrtar nga Rahoveci, media.

Stafi mbështetës i komisionit: Bajram Badivuku.

Mbledhjen e kryesoi **Nait Hasani**, kryetar i komisionit.

Për këtë mbledhje u propozua ky rend dite:

1. Miratimi i rendit të ditës ;
2. Miratimi i Procesverbalit të mbledhjes së komisionit, të mbajtur më 5.01.2012,
3. Shqyrtimi i Projektligjit për fshatin Hoçë e Madhe dhe Projektligjit për qendrën historike të Prizrenit,
4. Të ndryshme.

Kryesuesi konstatoi se janë plotësuar kushtet për fillimin e punës dhe hapi mbledhjen me pikën e parë të rendit të ditës.

1. Miratimi i rendit të ditës

Rendi i ditës u miratua pa ndryshime.

2. Miratimi i Procesverbalit të mbledhjes së mbajtur më 5.1.2012

Kryetari konstatoi se Komisioni miratoi Procesverbalin e mbledhjes së mbajtur më 5.1.2012. Për shkak të ofendimit me fjalë nga një përfaqësues i OJQ-së së Prizrenit në mbledhjen e kaluar, **Kryetari** njoftoi se për hera tjera duhet të njoftohemi paraprakisht kush po merë pjesë në mbledhjen e komisionit.

3. Shqyrtimi i projektligjit për fshatin Hoçë e Madhe

Kryetari i Komisionit pasi që paraprakisht njoftoi për shkresën nga Këshilli i trashëgimisë kulturore dhe për vërejtjet e deritanishme lidhur me këtë projekt i dha fjalën deputetëve.

Liburn Aliu tha se i bëri përshtypje shkresa nga Këshilli trashëgimor dhe konstatimi parimor se dy projektligjet janë në s'përputhje me parimet dhe normat bashkëkohore për mbrojtjen e trashëgimisë kulturore dhe se duhen riformuluar rrënjësisht në masë mbi 70%. Para se të shpallet një zonë e veçantë, vazhdoi, duhet me pas monumentin e shpallur veç e veç (objektin). Fillimisht ai kundërshtoi dy nenet e para.

Salih Morina tha se do të ishte mirë sot të bëhen analizat në mënyrë që në mbledhjen e radhës të shqyrtohen ato dhe të vendoset për amendamente eventuale dhe të janë sa më të harmonizuara.

Daut Haradinaj, Afërdita Berisha dhe **Nijazi Idrizi** u pajtuan me këtë sugjerim nga Salih Morina.

Komisioni u pajtua të bëhen analizat e duhura dhe të fokusohen vërejtjet konkrete nen për nen, në mënyrë që në mbledhjen e radhës të hartohen amendamentet konkrete :

Në tërë tekstin e Projektligjit duhet të zëvendësohet fjala **Komitet** me **Këshillë**.

Neni 1 dhe Neni 2

Duhet të ndryshohen pak por pa dëmtua esencën.

Neni 3, pika 1.13

Për KZM komisioni duhet të vendos në mbledhjen e radhës, ndërsa duhet të shtohet se ai i përgjigjet Këshillit për trashëgimi kulturore të Kosovës.

Neni 4, paragrafi 7

Në reshtin e parë “mund të marr vendim” bëhet “**mund të jap vërejtje**”.

Neni 5, paragrafi 5

Në reshtin e 3 hiqet “dhe qendrore”, ndërsa në vazhdim kur është fjala për referim pas KZM të shtohet : **Ministri të Kulturës, MMPH dhe KTKK**.

Neni 6

Të sqarohet “autoriteti i kufizuar” deri ku shkon ajo ose të hiqet.

Neni 7

Në paragrafin 1, në reshtin 1, hiqet “**ka të drejtë**”.

Neni 8

Në paragrafin 1 në reshtin e 2 pas fjalës “Fshatit” nëse shtohet “**planin e konservimit**” të shikohet a ka nevojë të qëndrojnë nënpikat e radhës. **Të riformulohet nga Gjejlane Hoxha**.

Neni 9

Është diskutabile. Duhet të shikohet a me mbet apo të fshihet. Përndryshe në paragrafin 4 pas KZM duhet të shtohen institucionet sikurse në nenin 5 (më lartë).

Në prezencën e deputetit **Hydajet Hyseni** u shqyrtuan amendamentet të parashtruara nga ai, si vijon :

Amendamenti 1

Titulli ekzistues e Projektligjit, riformulohet ne: **Ligj për aktivitetet e kufizuara ne Zonën e Veçantë te Mbrojtur te Hoçës së Madhe**.

Amandamenti 2

Neni 2

Shprehja “opseg prava sela...”(ne gjuhen serbe) te harmonizohet me shprehjen ne Angisht dhe shqip: “e drejta e fshatit “

Amendamenti 3

Neni 3. Paragrafi 1.9. dhe neni 4, titulli,

Emërtimet **Komitetet**, (Shqip, **Neni 3. Paragrafi 1. 10.**), **Comitee** (anglisht, **Neni 3. Paragrafi 1.10.) dhe Komisija** (serbisht, **Neni 3. Paragrafi 1.10.)** të harmonizohen me shprehjen në anglisht “Council (neni 4,)”, dhe te zevendesohen me **Këshill**, përkatësisht, **Savet**.

Amendamenti 4

Neni 4.1.

Fjala “përfaqëson”, zëvendësohet me: “kujdeset per...”

Amendamenti 5

Neni 4. 3

Numri prej 5 anëtarëve shtohet ne 7 anëtarë

Paragrafi 3.1

Numri 2 anëtarë nga Kuvendi shtohet ne 4. (nje nga Komiteti per kulture, nje nga Komiteti për planifikim hapsinor, një nga komiteti per financa dhe nje nga komitetete tjera)

Amendamenti 6

Neni 4. Paragrafi 3.3, neni 9 dhe gjithkund ne tekst

Emertimit “Kisha Ortodokse Serbe,” I shtohet :“ **Kisha Ortodokse Serbe**” ne Hoçë të Madhe ,

Amendamenti 7

Neni 5.1 fshihen fjalët:”... zbatojnë ose integrojnë...”

Amendamenti 8

Neni 5.2 dhe 6.1.1:

Në fund të secilit paragraf shtohet : **si dhe me Konventën e UNESCO-s per trashëgiminë Kulturore dhe Natyrore, Deklaratën Universale te UNESCO-s për Diversitetin Kulturor dhe ne Traktatin e Mastrohtit.**

Amendamenti 9

Neni 5.5

Shprehja :”...palet mund t ia referojne çështjen KZM për shqyrtim” zëvendësohet me: “...çështja mund të adresohet ne KZM...”

Amendamenti 10

Neni 8. Pragrafet 1.3 -1.9 barten ne nenin 6, përkatësisht nenin 7.

Disa nga këto amendamente u përkrahën ngase përshtateshin me sugjerimet e komisionit. Në mbledhjen e radhës do të shqyrtohen një nga një duke i dhënë apo duke mos i dhënë përkrahjen e komisionit (sqarim : këto amendamente paraqiten në tabelën përfundimtare sinoptike duke shënuar në fund të çdo amendamenti a është përkrahur apo jo nga komisioni).

Në mbledhjen e radhës duhet të jepet mendimi i komisionit edhe për amendamentet e Qeverisë dt. 13.9.2011 (për përkrahje apo mospërkrahje) si vijon :

Amendamenti 1

Neni 4 – Komiteti

Të zëvendësohet neni ekzistues 4.3, me:

3. Komiteti përbëhet prej 7 anëtarëve:

3.1. tre (3) anëtarë duhet të zgjedhen drejtpërdrejtë nga qytetarët e zonës kadastrale të Hoçës se Madhe;

3.2. tre (3) anëtarë duhet të zgjedhet nga

Komuna;

3.3 një (1) anëtar duhet të zgjedhet nga Kisha Ortodokse Serbe.

Amendamenti 2

Neni 5- Marëdhëniet ndërmjet komitetit dhe Autiriteteve Komunale dhe Qëndrore

Të shtohet (nën nenin 5.4.):

Të drejtat dhe autorizimet që i jepen fshatit me këtë Ligj nuk mund t'i barten një autoriteti tjetër.

Amendamenti 3

Neni 7- Autoriteti i kufizuar për aktivitetet në fushën e planifikimit rural

Të shtohet në fund të nenit:

1.3. pjesëmarrjes në procesin e lëshimit e lejeve, siç parashihet në nenin 9 të këtij Ligji, me të drejtën për të refuzuar lëshimin e lejes së ndërtimit nëse konsideron se ndërtimi nuk është në përputhje me planet hapësinore dhe urbane dhe me ligjin në fuqi.

1.4. Në rast mospajtimesh ndërmjet Komunës dhe Fshatit për refuzimin ose lëshimin e lejes së ndërtimit, palët e përcjellin çështjen tek KZM-ja për shqyrtim.

Amendamenti 4

Të shtohet (pas nenit 8):

Neni 9 -Procedura e shqyrtimit të kërkesave për leje në kuadër të ZVM

1. Përveç kushteve për dhënie të lejeve që kërkohen sipas legjislacionit në fuqi, procedura për dhënien e kërkesave për leje në ZVM përfshin edhe ndërmarrjen e këtyre veprimeve:

1.1. Komuna i dorëzon Komitetit të gjitha kërkesat e shqyrtuara për leje brenda ZVM-së me rekomandimet e saj profesionale;

1.2. Komiteti i shqyrton të gjitha rekomandimet për leje në përputhje me ligjet në fuqi;

1.3. Komiteti mund të refuzojë një rekomandim për leje vetëm nëse konsideron se ajo nuk është në përputhje me planet hapësinore dhe urbane dhe ligjet në fuqi;

1.4. Komiteti e shqyrton rekomandimin për leje, dhe e informon Komunën për pëlqimin ose refuzimin nga ana e tij brenda 15 ditësh;

1.5 Komuna i shqyrton rekomandimet e Komiteti në të gjitha rastet;

1.6. Nëse Komiteti nuk përgjigjet brenda 15 ditësh, konsiderohet se rekomandimi i Komunës ka marrë pëlqimin nga Komiteti;

Amendamenti 5

Dispozitat të cilat duhet të fshihen

Përmbajtja e tërë Neni 9 ekzistues (“ Aktivitetet e Reja dhe Marrëveshja me Kishën Ortodokse Serbe”) duhet të fshihen, sepse të gjitha dispozitat për shqyrtimin e lejes së ndërtimit (duke përfshi edhe përmbajtjen e nenit me titull “**Procedura e shqyrtimit të kërkesave për leje në kuadër të ZVM**”, janë të rishtuar në brendi të Ligjit.

Komisioni në mbledhjen e radhës do të shqyrtoi amendamentet konkrete që do të saktësohen për Hoçën, dhe do të vazhdoi me shqyrtimin e projektligjit për Prizrenin.

Mbledhja e komisionit përfundoi në orën 15,50 (me një pauzë prej 13,00-14,00).

Përgatitur nga:

Njësia për Mbështetjen e Komisionit

Kryetari i Komisionit,
Nait Hasani